


# ECCO

UMBERTO



# Tri rrëfenja

Ilustruar nga Eugenio Carmi



Letërsi e huaj për fëmijë  
Umberto Eco  
Ilustruar nga Eugenio Carmi  
Tri rrëfenja  
DITURIA

Eugenio Carmi, piktor, është vetëquajtur  
“fabrikues i imazheve”.  
Me Umberto Eco u bë ilustrues.

Umberto Eco, profesor universiteti,  
eseist, shkrimtar, është vetëquajtur  
“fabrikues i fjalëve”.  
Me Eugenio Carmin u bë rrëfenjës.

Umberto Eco

# **Tri rrëfenja**

Ilustruar nga Eugenio Carmi

Përktheu: Edon Qesari

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli original:  
Umberto Eco, Eugenio Carmi  
*Tre Racconti*

Redaktore: Mariana Ymeri  
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© Giunti Editore S.p.A. / Bompiani, Firenze-Milano  
2015 First edition as anthology published under Bompiani imprint  
[www.giunti.it](http://www.giunti.it)  
[www.bompiani.it](http://www.bompiani.it)

1966 First publication of “The Bomb and the Generai” and  
“The three cosmonauts” under Bompiani imprint  
1992 First publication of “The Gnomes of Gnu” under Bompiani imprint

© Copyright për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit Europian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.


Questo libro è stato tradotto grazie ad un contributo del Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale italiano

Ky libër është përkthyer me mbështetje nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Italian

Shtëpia Botuese DITURIA  
Rruga “Frederik Shiroka”, Nr. 31, Tiranë  
P.O. Box 1441  
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503  
E-mail: [sekretaria@dituria.al](mailto:sekretaria@dituria.al)  
[www.dituria.al](http://www.dituria.al)  
■ Shtëpia Botuese DITURIA


# **Bomba dhe gjenerali**

Na ishte njëherë  
një atom.





Dhe na ishte njëherë  
një gjeneral i keq  
me një uniformë plot gajtanë.



Bota është plot atome.

Gjithçka përbëhet nga atomet:  
atomet janë shumë të vogla  
dhe kur mblidhen bashkë  
u japin formë molekulave,  
të cilat paskëtaj  
formojnë gjithë gjërat që ne njohim.

Mami përbëhet nga atomet.  
Qumështi përbëhet nga atomet.  
Gruaja përbëhet nga atomet.  
Ajri përbëhet nga atomet.  
Zjarri përbëhet nga atomet.  
Ne përbëhemi nga atomet.



Në çastin kur atomet  
qëndrojnë së bashku harmonishëm,  
gjithçka shkon për së mbari.  
Jeta mbështetet mbi këtë harmoni.

Ama, kur një atom copëtohet...  
pjesët e tij godasin atome të tjera,  
të cilët godasin prapë atome të tjera  
e kështu me radhë...

Një shpërthim i frikshëm ndodh!  
Kjo është vdekja atomike.



E kështu,  
atomi ynë që i mërzhitur  
sepse e kishin vendosur  
brenda një bombe atomike.

Së bashku me të tjera atome  
priste ditën  
kur bomba do të hidhej  
dhe ato do të copëtoheshin,  
duke shkatërruar çdo gjë.





Tani, ju duhet të dini  
se bota është gjithashtu plot  
me gjeneralë  
që shtyjnë kohën duke mbledhur bomba.

Kështu, gjenerali ynë  
mbushte papafingon e vet me bomba.  
“Kur të kem shumë”,  
thosh ai,  
“do të nis një luftë të bukur fort!”

Dhe qeshte.

Përditë  
gjenerali hipte në papafingo  
dhe shpinte nga një bombë të sapoardhur.  
“Kur të kem shumë”,  
thosh ai,  
“do të nis një luftë të bukur fort!”

A është e mundur të mos bëhesh i lig  
kur ke gjithë ato bomba ndër duar?



**ha ha!**



Atomët e kyçura në bomba  
ishin shumë të mërzitura.

Për shkak të tyre  
do të ndodhte një gjëmë e stërmadhe:  
do të vdisnin shumë fëmijë,  
shumë mama,  
shumë kotele,  
shumë dhi të vogla,  
shumë zogj të vegjël,  
të gjithë, me një fjalë.

Do të zhdukeshin vende të tëra nga faqja e dheut:  
atje ku më parë gjendeshin shtëpiza të bardha  
me çati të kuqe  
dhe pemë me gjelbërim përreth...

